

SIGURIA E FËMIJËVE NË INTERNET

UDHËZUES PËR FËMIJË

Siguria e Fëmijëve në Internet **Udhëzues për fëmijë**

Autorët:

Teuta Zymeri

Besianë Musmurati

Qendra për studime të avancuara – FIT

Dizajni dhe faqosja:

Envinion

Botuar nga:

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

Ky dokument u hartua në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian "Mbrojtja e fëmijëve nga rreziqet në internet - PROCON", që menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Projekti implementohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në bashkëpunim me Këshillin Rinor Kosovor (KYC) dhe International Children Safety Service (ICSS) dhe në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e organizatave zbatuese dhe në asnjë rrethanë nuk i atribuohet donatorit.

PARATHËNIE

Udhëzuesi për Fëmijë mbi sigurinë e fëmijëve në internet është përgatitur nën përgjegjësinë e përbashkët të dy organizata joqeveritare, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe Qendra për Studime të Avancuara (FIT). Përgatitja e Udhëzuesit është e bazuar në përvojën disavjeçare të dy organizatave në fushën e sigurisë së fëmijëve në internet si dhe në konsultime të vazhdueshme të bëra me ekspertë të brendshëm dhe të jashtëm të kësaj lëmie.

Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë informative në vitet e fundit i asociuar edhe me rritjen e nivelit të rreziqeve të shfaqura si rrjedhojë e kyçjes jo të sigurt të fëmijëve në internet, në shumë vende të botës ka nxjerrë në pah rëndësinë e masave të që duhet të merren me qëllim që të mbrohen fëmijët në internet. Në këtë kontekst, fokusi i këtij Udhëzuesi është të ofroi rekomandime kyçe për fëmijët dhe të bëjë promovimin e një interneti sa më të sigurtë për fëmijët tanë. Ky Udhëzues mund të shërbej si një burim i rëndësishëm reference për përdoruesit e internetit dhe ne ju inkurajojmë aplikimin e rekomandimeve të ofruara përmes

këtij udhëzuesi në rastet kur fëmijët qasen në internet.

Konceptet e paraqitura në këtë Udhëzues janë të harmonizuara edhe me udhëzues të përgatitur nga vendet e Bashkimit Evropian të cilat janë anëtare të një rrjeti të quajtur "EU Kids Online Network".

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	3
Hyrje.....	6
Ndryshimet kryesore të inkuorporuar në botimin e dytë.....	7
Interneti dhe kuptimi i tij	8
Njihu me teknologjinë.....	11
Përdorimi i internetit, aktivitetet kryesore dhe rreziqet online	13
5 rreziqet për fëmijët në internet.....	14
Sajberdhuna	15
Publikimi dhe keqpërdorimi i të dhënave personale	19
Lojërat Online.....	21
Rreziku ndaj ekspozimit të materialeve me përmbajtjeve të papërshtatshme.....	24
Takimi me njerëz të panjohur	30
Trafikimi i fëmijëve	31
Abuzimi seksual ndaj fëmijëve.....	32
Shkarkimi, shkëmbimi dhe postimi	32
Viruset, siguria kibernetike, etj.....	33
Telefoni Celular	34
Chat	35
E-mail.....	35
Forumet	36
Të drejtat e fëmijëve në internet.....	36
Përgjegjësitë e fëmijëve në internet	37
Disiplina dhe kujdesi në internet	38
Këshilla se si të mbroheni në internet.....	38
Fjalori termeve të informatikës.....	40

HYRJE

Publikimi i Udhëzuesit për Fëmijë është rezultat i punës disa mujore të Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC) dhe Qendrës për Studime të Avancuara FIT, në bashkëpunim me ekspertë vendor dhe ndërkombëtarë të kësaj fushe. Udhëzuesi është azhurnim i botimit të parë të publikuar në vitin 2012, për të ofruar udhëzimeve që të ndihmoj fëmijët lidhur me sigurinë në internet dhe mund të shërbej edhe për nxjerrjen e rekomandimeve të rëndësishme për politikëbërësit. Kjo iniciativë është mbështetur financiarisht nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë në kuadër të projektit “Mbrojta e Fëmijëve nga Rreziqet në Internet - PROCON”. Mendimet, përfundimet, konkludimet apo rekomandimet e shprehura në këtë dokument këtu janë të Qendrës KEC dhe Qendrës FIT dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Kemi kënaqësinë që nëpërmjet këtij dokumenti t’iu ofrojmë këshilla dhe udhëzime lidhur me përdorimin e sigurt të internetit për fëmijët. Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është që t’iu ofrojmë fëmijëve informata për rreziqet që mund të paraqiten gjatë përdorimit të internetit dhe të kontribuoj në rritjen e vetëdijesimit për sigurinë në internet. Ky Udhëzues merr për bazë zhvillimet e shpejta të teknologjisë, integrimin e rrjeteve sociale në telefona të mençur, përhapjen e wireless-it dhe

çështjet që kanë të bëjnë me sjelljet e fëmijëve në ditët e sotme. Për më shumë, diskuton edhe çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e fëmijëve online siç janë shkarkimi i materialeve, postimi, bisedat në ‘chat’, hapja e profileve dhe publikimi i të dhënave personale.

Ky udhëzues është hartuar për të ofruar informata dhe këshilla për fëmijë dhe objektivat kryesore të këtij udhëzuesi janë:

- (a) rritja e vetëdijesimit të fëmijëve lidhur me sigurinë në internet;
- (b) informimi i fëmijëve lidhur me rreziqet potenciale gjatë përdorimit të internetit;
- (c) ofrimi i këshillave dhe udhëzimeve se si fëmijët t’i evitojnë rreziqet para se ato të bëhen probleme serioze.

Ne ju rekomandojmë fëmijëve të përdorin këtë udhëzues për shfletim të sigurt në internet.

NDRYSHIMET KRYESORE TË INKORPORUAR NË BOTIMIN E DYTË

Struktura e përgjithshme nga botimi nuk ka ndryshuar shumë dhe botimi i dytë është një vazhdimësi e botimit të parë. Në këtë version janë shtuar pjesë në secilin kapitull si dhe janë ndryshuar shumë pjesë për të qenë më në kohë me zhvillimet e fundit të teknologjisë. Botimi i dytë është zgjeruar në përmbajtje duke shtuar tema të reja dhe elaboruar më në detaje temat që kanë qenë në botimin e parë. Disa nga ndryshimet më të rëndësishme nga edicioni paraprak janë si më poshtë:

- Temat janë elaboruar më gjerësisht dhe janë dhënë më shumë shembuj në botimin e dytë;
- Janë shtuar tema të reja, përfshirë njohjen me teknologjinë informative, publikimi dhe keqpërdorimi i të dhënave personale, rreziqet nga viruset, gjuha e urrejtjes, varësia nga interneti, etj.
- Është shtuar një fjalor i termeve kibernetike.

Ky udhëzues merr për bazë zhvillimet e shpejta të teknologjisë, për shembull, integrimin e rrjeteve sociale në telefona të mençur, përhapjen e wireless-it dhe çështjet që kanë të bëjnë me sjelljet e fëmijëve në ditët e sotme.



Interneti dhe kuptimi i tij

Interneti është një rrjet global i kompjuterëve të lidhur që janë në gjendje të komunikojnë nëpërmjet kablllove, linjave telefonike dhe satelitëve. Lidhja me internet ju mundëson për të transmetuar dhe shpërndarë informacione, të cilat mund të jenë në formë të tekstit, fotografisë, videos, muzikës etj. Përdoruesit fusin këto informacione në internet

dhe të njëjtat mund të lexohen, shikohen apo shkarkohen nga përdoruesit e tjerë.

Për ta kuptuar më lehtë se si funksionon interneti, ne po marrim një shembull të thjeshtë për ilustrim. Supozojmë që në shkollën tuaj ka dy kompjuter të cilët janë të lidhur në mes vete përmes një

modemi i cili ju mundëson kompjuterëve të këmbëjnë informacionet. Tani nëse supozojmë që lidhje të ngjashme ka edhe në shkolla të tjera midis kompjuterëve në ato shkolla, dhe nëse të gjitha këto mini-rrjete brenda shkollave lidhen së bashku në një rrjet të vetëm nga njëri kompjuter tek tjetri, atëherë kjo quhet inter-net. Fjala 'inter' ka kuptimin 'midis' dhe 'net' ka kuptimin e 'rrjeteve', që në gjuhë angleze quhen networking. Me fjalë të tjera, interneti është një mënyrë e dërgimit të informacionit nga një kompjuter në një tjetër kudo në botë dhe paraqet një sistem global të rrjeteve të ndërlidhura kompjuterike të disa miliardapajisjeve në botë. Është një formë e komunikimit e ngjashme me atë në botën tonë reale.

Interneti për herë të parë është zbuluar nga një grup i hulumtuesve amerikanë në vitin 1960 në Los Angeles. Pas vitit 1960, një numër i madh i bizneseve, universiteteve dhe hulumtuesve ju bashkuan këtij rrejt derisa ata krijuan një web të rrjeteve të lidhura në mes vete. Më vonë, edhe njerëzit e zakonshëm filluan të përdorin internetin dhe sot ka me miliona njerëz në gjithë botën që mund të përdorin internetin në mënyra të ndryshme.

Komunikimi nga një pajisje kompjuterike në tjetrën duke përdorë internetin është një mundësi e mrekullueshme. Për shumë kënd, kjo lidhje në

rrjet ofron mundësi të mirë të shfrytëzimit të informatave të ngarkuara në internet për punë, edukim, komunikim e jetë shoqërore. Duke përdorë internetin fëmijët janë në gjendje të udhëtojnë nëpër botë pa pasur nevojë të dalin nga dhoma e tyre (p.sh. përmes Google earth), të vazhdojnë të mësojnë pas përfundimit të orëve të mësimit në shkolla, të komunikojnë me njëri tjetrin dhe të krijojnë produkte të ndryshme në internet të cilat mund të shikohen nga e gjithë bota (p.sh. ueb-faqe personale, blogs, fotografi, etj).

Mirëpo ajo që është e rrezikshme në këtë mes është faktori njeri dhe duke pas parasysh që miliona njerëz janë të kyçur në rrjet të internetit, edhe numri i keqpërdoruesve është i madh. Në anën tjetër përdorimi i internetit nga fëmijët është rritur dhe në këtë aspekt, hulumtime të ndryshme kanë gjetur se fëmijët që e përdorin internetin më shumë kanë mundësi që të mësojnë më shumë dhe të ekspozohen ndaj rreziqeve më shumë. Prandaj, siguria në internet është shumë e rëndësishme dhe ne duhet të mësohemi që të mbrohemi nga keqbërësit kur kyçemi në internet.

Në internet mund të kyçet çdokush nëse ka një kompjuter apo pajisje të ngjashme elektronike e cila është e lidhur në internet dhe ka një llogari me një ofrues të shërbimit të internetit. Interneti nuk ka ndonjë vendndodhje të caktuar, apo ndonjë seli qendrore. Ai është i projektuar për të vepruar nga

shumë vende të ndryshme. Asnjë organizatë apo individ në botë nuk është pronar i internetit, por secili shtet nxjerr ligje në lidhje me përdorimin ose përmbajtjen e tij.

Pasi të jeni lidhur në internet ju mund të hyni në një shumëllojshmëri të aktiviteteve të quajtura shërbimet e internetit. Numri i shërbimeve të ofruara në internet është rritur në mënyrë të vazhdueshme me avancimin e teknologjisë. Shërbimet më të popullarizuara në internet që aktualisht përdoren janë:



Shfletimi i faqeve të internetit (anglisht: webBrowsing) - bëhet duke përdorur një program të veçantë për shfletim, siç janë: Internet Explorer, Safari, Firefox, Opera, Google Chrome e të ngjashme, për të kërkuar dhe shikuar faqe të internetit, të cilat mund të kenë tekst, fotografi, muzikë, video, lojëra, etj.



E-mail - është një shërbim që ju lejon të dërgoni mesazhe të shkruara, muzikë, video etj., tek një person tjetër nëpërmjet internetit. Mesazhet ruhen në kompjuter dhe lexohet kur personi tjetër (marrësi) kontrollon e-mail adresën e tij.



Chat - përdoret për të dërguar mesazhe të menjëhershme për njerëzit e tjerë që janë të kyçur në "chat", d.m.th krijohet

një lloj bisede virtuale. Këto biseda mund të bëhen me miqtë apo me të panjohurit. Dhomat e chatit (anglisht: chatrooms) janë vende virtuale të takimit ku njerëzit takohen për të komunikuar dhe dërguar mesazhe njeri tjetrit.



Forumet - janë vende virtuale në internet ku njerëzit mund të postojnë mesazhe në lidhje me një temë. Njerëzit me interesa të ngjashme mund të lexojnë mesazhet dhe postojnë përgjigje.

Si përfundim po e përsërisim edhe njëherë se fëmijët mund të bëjnë një mori aktiviteteve në internet, mirëpo gjithmonë duhet pasur parasysh se internetin e përdorin shumë njerëz anë e kënd botës dhe për arsye të ndryshme. Disa e përdorin për qëllime të mira kurse të tjerët e përdorin për qëllime të këqija. Prandaj, fëmijët duhet të bëhen të mençur dhe të shfletojnë të sigurt në internet.



Njihu me teknologjinë

Teknologjitë e reja ofrojnë shumë mënyra për të komunikuar dhe ato janë bërë pjesë e madhe e mjedisit shoqëror të fëmijëve. Bota e kompjuterëve, laptopëve, iPad, telefonave mobil të mençur, sistemet e lojërave dhe interneti janë vazhdimisht duke u zgjeruar dhe avancuar. Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë informative ka ndikuar që të ndryshojnë edhe sjelljet e fëmijëve në ditët e

sotme. Fëmijët zakonisht kërkojnë të përdorin teknologjitë e fundit dhe shpesh ata janë më të dijsëm se të rriturit. Ata kërkojnë kompjuterët dhe telefonat celularë të ri, dëshirojnë të vizitojnë faqete reja të internetit, të shkarkojnë e instalojnë Apps dhe Gadgets.

Mirëpo paraprakisht duhet pajisur me rregullat bazike për sigurinë në internet në mënyrë që fëmijët të përdorin këto teknologji me përgjegjësi. Bazuar në një hulumtim që ka bërë Qendra FIT me të dhëna të mbledhura nga një pyetësor me 1.150 fëmijë të moshës 9-16 vjeç nga shtatë shkolla në shtatë komunat më të mëdha të Kosovës ka dalë që fëmijët kyçen në internet kryesisht përmes kompjuterëve dhe telefonave mobil. Gjetjet nga ky hulumtim tregojnë që përdorimi i telefonave mobil për t'u kyçur në internet është rritur ndjeshëm në dy vitet e fundit.

Fëmijët duhet mësuar se si të përdorin teknologjinë por njëherit edhe të vendosin rregulla se sa

gjatë brenda ditës do të përdorin këto teknologji. Akademia Amerikane e Pediatriisë rekomandon që për moshat deri në dy vite fëmijët nuk duhet të shpenzojnë kohë para ekranit.

Ndikimi i teknologjisë në jetën e fëmijëve dhe adoleshentëve në Kosovë është duke u rritur. Sot është vështirë të definohet se cila është teknologjia e mjaftueshme që një fëmijë duhet të përdorë. Duke pas parasysh se teknologjia po zhvillohet shpejtë, dhe po ofron më shumë, përqindja e kohës që fëmijët kalojnë para pajisjeve teknologjike po rritet.



PËRDORIMI I INTERNETIT, AKTIVITETET KRYESORE DHE RREZIQET ONLINE

Në bazë të hulumtimeve të bëra nga Qendra FIT në vitin 2012 dhe 2014, ka dalë që fëmijët Kosovarë janë mjaftë aktiv në internet, bile krahasuar me mesataren e fëmijëve të Evropës ka dalë që fëmijët Kosovarë e përdorin internetin më shumë. Në Kosovë mbi 90 % e fëmijëve të moshës 9-16 vjet e përdorin internetin. Rreth 65 % e tyre e përdorin internetin çdo ditë ose gati çdo ditë. Gjysma e fëmijëve që e përdorin internetin çdo ditë apo gati çdo ditë, kalojnë më shumë se dy orë online, prej të cilëve 5 % qëndrojnë më gjatë se katër orë online.

Në bazë të hulumtimit ka rezultuar që aktivitetet kryesore të shumicës së fëmijëve Kosovarë në internet janë rrjetet sociale, YouTube dhe dëgjimi i muzikës. Fëmijët duhet të dinë që shumë nga aktivitetet në internet u ofrojnë atyre njohuri të mira dhe të dobishme, mirëpo në të njëjtën kohë shumë prej këtyre aktiviteteve përmbajnë një rrezik potencial për fëmijët.

Shpeshherë në faqet e lojërave në internet, rrjete sociale, youtube apo faqe të tjera, ku fëmijët kalojnë mjaft kohë, ata ekspozohen ndaj dhunës kërcënuese që bëhet nga fëmijët e tjerë, shfaqja e materialeve me përmbajtje të papërshtatshme, keqpërdorimi i të dhënave personale, atakimi me virus të ndryshëm, etj. Prandaj fëmijët duhet pasur kujdes sepse përdorimi i pasigurt i internetit mund të ketë pasoja negative për ta.





5 rreziqet për fëmijët në internet

Fëmijët duhet të mbajnë mend që interneti është një vend i mrekullueshëm për të vizituar i cili ju sjell fëmijëve shumë ide, komunikim të mirë me njerëz dhe përvojë të pasur. Mirëpo fëmijët duhet gjithashtu të kuptojnë se ata duhet tu përmbahen disa rregullave në mënyrë që të jenë më të sigurt kur janë online. Për faktin se ka rreziqe në internet, fëmijët nuk mund të kufizohen nga përdorimi

i internetit, sepse në ditët e sotme përdorimi i internetit është një pjesë natyrore e zhvillimit të fëmijëve. Normalisht, edhe pse ka rreziqe, interneti nuk duhet të jetë një vend i rrezikshëm për fëmijët.

Përdorimi i internetit është një burim i madh për të ndihmuar fëmijët në përgatitjen e detyrave të shtëpisë, pastaj fëmijët e përdorin për të luajtur

lojëra, shprehur kreativitetin e tyre ose për të vizituar faqet e tyre të preferuara. Duke qenë të vetëdijshëm për kërcënimet që mund tu ndodhin fëmijëve në internet, ata duhet të mësojnë të gjitha rreziqet e përdorimit të internetit dhe pastaj të marrin masat përkatëse për të shmangur këto rreziqe.

Sajberdhuna

Sajberdhuna është përdorimi i qëllimshëm dhe i përsëritur i mjeteve elektronike (si psh. internetit apo telefonit mobil) nga fëmijët dhe adoleshentet për të ngacmuar, kërcënuar, munduar, poshtëruar, turpëruar apo përdorimi i ndonjë forme tjetër e të dhunës ndaj një fëmije apo adoleshenti tjetër. ‘Cyberbullying’ është terminologji në gjuhën angleze që përdoret kur njerëzit përdorin internetin për të kërcënuar, ngacmuar apo poshtëruar dikë duke dërguar mesazhe të këqija, fotografi dhe video tronditëse të personat e panjohur. Ka shumë forma të sajberdhunës, mirëpo këto janë më të shpeshtat:

- Dërgimi i e-mailave që mund të jenë kërcënues apo shqetësues (psh. mesazhe fyese, raciste apo paragjykime të tjera);
- Dërgimi ose postimi i thashethemeve të shokët apo direkt të viktimave;

Në vijim do japim një përshkrim të pesë rreziqeve më të larta me të cilat fëmijët mund të përballen në internet dhe çfarë duhet të bëjnë ata për tu mbrojtur nga këto rreziqe.

- Postimet në rrjetet sociale — psh. i sekreteve të dikujt (p.sh. Facebook ose Twitter);
- Fyerja e fëmijëve duke ju vënë nofka apo pseudonime përmes mesazheve, komunikimit në Chat, postimit në Facebook, etj.;
- Dërgimi ose postimi i fotografive të personave të tjerë, pa lejen e tyre (zakonisht fotografi turpëruese ose intime/personale) në internet;
- Krijimi i profileve apo ueb-faqeve të caktuara në internet, duke shënjestruar një individ apo grup të caktuar fëmijësh me qëllim talljeje apo fyerjeje.

Fëmijët përdorin metoda të ndryshme për të ushtruar sajberdhunë, mirëpo më të shpeshtat

janë mesazhet nëpërmjet telefonave mobil, e-mail, chat-it, fotografi, Uebfaqet të dedikuara ndaj dikujt për të shënjestruar një individ apo grup të caktuar fëmijësh. Është me rëndësi që, nëse keni pranuar mesazhe me përmbajtje fyese apo kërcënuese, asnjëherë të mos ju përgjigjeni, e vetmja gjë që duhet të veproni është të injoroni

mesazhin. Preferohet që mesazhet e tilla të ruhen si dëshmi për raportim eventual. Por në këto raste duhet patjetër të njoftoni një të rritur në familjen tuaj për këtë gjë që ata të gjejnë mënyra për të ju ndihmuar. Gjithmonë respektoni njerëzit e tjerë dhe jeni të vetëdijshëm për atë që pranoni dhe dërgoni gjatë kohës që ju jeni në internet.

METODAT DHE TEKNOLOGJIA E PËRDORUR

Fëmijët përdorin metoda dhe teknologji të ndryshme për të ushtruar sajberdhunë, mirëpo më të shpeshtat janë këto:

- Telefonatat, mesazhet përmes telefonit;
- E-mailat apo mesazhet e çastit (msn);
- Fotografitë digjitale (nga aparatet digjitale dhe telefonat mobil);
- Dhomat e chat-it, dhomat e diskutimit dhe grupet e ndryshme të chat-it në internet;
- Uebfaqet e dedikuara ndaj dikujt për të shënjestruar një individ apo grup të caktuar fëmijësh;
- Liria e shprehjes është e garantuar për të gjithë, mirëpo shpesh uebfaqet e tilla

ngacmojnë nëvazhdimësi një fëmijë apo grupe të caktuar fëmijësh, dhe një sulm i tillë bëhet barrë për individët e sulmuar, duke iu pamundësuar funksionim normal të jetës së tyre.



PËRSE FËMIJËT NGACMOJNË NJËRI-TJETRIN?

Fëmijët shpeshherë ngacmojnë nëpërmjet internetit të motivuar nga zemërimi, hakmarrja ose inati. Nganjëherë ngacmojnë të tjerët për zbavitje apo ngase janë të mërzitur dhe kanë tepër kohë të lirë. Shpesh, është vështirë të përcaktohet

toni i dërguesit. Shakaja e një personi mund të jetë ofendim i rëndë për një person tjetër! Mirëpo, dërgimi i njëpasnjëshëm i e-mailave, mesazheve, dhe postimeve është rrallëherë i paqëllimshëm.



PARANDALIMI I SAJBERDHUNËS

Ju mund të ndërmerri disa hapa për të parandaluar sajberdhunën:

- Mos iu përgjigjini ngacmuesve. Mos i lexoni mesazhet etyre, bllokoni ata persona dhe mos komunikoni me ta;

- Asnjëherë mos u hakmerrni ndaj atyre që ju ngacmojnë;
- Mos i tregoni askujt fjalëkalimet tuaja, përveç prindërve tuaj;
- Është e rëndësishme t'ju tregoni prindërve tuaj nëse bëheni viktimë e ngacmimit;
- Ruani dëshmitë lidhur me ngacmimet online;
- Mundohuni ta identifikoni personin i cili ju ngacmon!

PASOJAT E SAJBERDHUNËS

Viktimat e sajberdhunës pësojnë të njëjtat efekte negative sikurse ngacmimi në jetën e përditshme, por shpesh efektet e sajberdhunës janë më të mëdha për shkak se mesazhet mund të bëhen publike dhe mund të shihen nga njëaudiençë e madhe e pa kufi.

Rreziku më i madh vjen nga fakti se ky abuzim i filluar nëpërmjet internetit, shpesh nuk ndalet me aq, mirëpo mund të vazhdojë t'i ndjek fëmijët edhe në jetën e përditshme duke i shqetësuar ata gjatë aktiviteteve ditore e duke ndikuar në jetën normale të tyre.

KENI KUJDES...

Ju mund të ndërmerrni disa hapa për të parandaluar sajberdhunën:

- Mos iu përgjigj ngacmuesve.
- Mos i lexoni mesazhet e tyre, bllokoni ata persona dhe mos komunikoni me ta.
- Asnjëherë mos u hakmerrni ndaj atyre që ju ngacmojnë.
- Mos i tregoni askujt fjalëkalimet tuaja përveç prindërve tuaj.
- Është e rëndësishme t'ju tregoni prindërve tuaj nëse bëheni viktimë e ngacmimit.
- Ruani dëshmitë lidhur me ngacmimet online.
- Mundohuni ta identifikoni personin i cili ju ngacmon.



Publikimi dhe keqpërdorimi i të dhënave personale

Çfarë janë të dhënat personale?

Të gjitha informacionet që mund të identifikojnë personalitetin tuaj paraqesin të dhëna personale. Emri, mbiemri, fotografia nga e cila ju mund të identifikoheni, datëlindja, adresa, profesioni, numri i telefonit, IP adresa e kompjuterit, janë të gjitha të dhëna personale.

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale

Mbrojtja e të dhënave personale është e drejtëfundamentale e garantuar me Kushtetutë neni 36 dhe e rregulluar edhe me Ligjin 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky ligj ka për qëllim që ti të jeni të sigurt se të dhënat tuaja personale shfrytëzohen në mënyrë të drejtë dhe nuk keqpërdoren. Njëherit, mbrojtja e të drejtës në privatësi është e garantuar me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Mbrojtja e të dhënave personale është pjesë e së drejtës në privatësi, si një nga të drejtat dhe liritë elementare të njeriut.

Përdorimi i të dhënave personale - Të dhënat tuaja personale nuk mund të shfrytëzohen nga të tjerët pa pëlqimin tuaj. Ju mund të jepni pëlqimin tuaj në mënyrë vullnetare dhe këtë pëlqim keni të drejtë ta tërhiqni në çdo kohë. Është e drejtë e juaja të kërkonte nga miqtë tuaj që mos postojnë informata ose foto tuajat në blogjet dhe faqet e rrjeteve sociale pa lejen tuaj.

Ju keni të drejtë të jeni të informuar se çfarë të dhënash personale ruajnë të tjerët për ju, për çka do t'i shfrytëzojnë dhe në çfarë mënyre kanë ardhur deri te të dhënat e juaja personale. Ju gjithmonë keni të drejtë të kërkonte që të dhënat e juaja që nuk janë të sakta dhe të kompletuara të korrigjohen. Nëpërmjet motorëve të kërkimit

(p.sh. Google, Yahoo) kërkoni emrin tuaj për tekst dhe foto. Nëse në një faqe interneti gjeni informata të ndjeshme për veten tuaj, drejtohuni kësaj faqe me një kërkesë për të hequr informacionet tuaja nga kjo faqe. Për të dhënat personale të ndjeshme (të dhënat që zbulojnë origjinën etnike ose racore, përkatësinë fetare, jetën seksuale, shëndetin, veprimet penale) çdoherë duhet të kërkohet pëlqimi me shkrim.

Rregullat dhe përgjegjësia - Është me rëndësi që të jeni i informuar për përgjegjësinë tuaj kur dëshironi të ndani diçka me pjesën tjetër të botës. Për çdo gjë që ju publikoni në internet, mbani përgjegjësi të plotë. Rekomandohet që të lexoni së pari politikat e privatësisë për faqet e internetit në të cilat dëshironi të publikoni të dhëna personale.

Kur publikoni informata personale për veten tuaj apo për të tjerët, mbeten gjurmë elektronike në internet, siç janë IP adresa dhe evidenca e përdoruesit, të cilat janë informata të mjaftueshme për të zbuluar identitetin e secilit që bën publikimin e atyre të dhënave. Prandaj para se të publikoni gjithmonë duhet të kërkoni pëlqimin paraprakisht.

Në vende publike shpesh janë të vendosura kamera për incizime. Megjithatë në ato zona duhet të ketë njoftim të çartë se ajo hapësirë është nën vëzhgimin e kamerave. Njëherit është i ndaluar edhe tregimi i incizimit palës së tretë pa pëlqimin

e personave të incizuar, përveç policisë. Publikimi i videove dhe i muzikës pa përdorimin e të drejtës për publikim është i paligjshëm. Mbrojtja e të drejtave të autorësisë është e garantuar me ligj.

Si të kërkojmë fshirjen e të dhënave personale - Ju gjithmonë mund të kërkoni fshirjen e të dhënave, të cilat janë të publikuara pa lejen tuaj. Kjo mund të bëhet në këtë mënyrë:

Duke kontaktuar personin i cili ka bërë publikimin e të dhënave personale nga i cili kërkoni që të bëjë fshirjen e tyre;

Ju mund të kërkoni nga ofruesi i shërbimit të internetit (anglisht internet provider) që të bëjë fshirjen e të dhënave tuaja personale;

Njoftoni prindin ose kujdestarin tuaj; Kontaktoni Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës.

Këshilla për mbrojtje më të mirë

- Lexoni me kujdes politikat e privatësisë për faqet e internetit të cilat i përdorni;
- Publikoni sa më pak detaje që ju identifikojnë juve apo vendndodhjen tuaj;
- Kujdes, mos publikoni online gjëra të cilat nuk dëshironi të jenë publike;
- Mos ndani e-mail adresën private me njerëz që nuk i njihni dhe mbani vetëm për vete fjalëkalimin;
- Gjatë regjistrimit apo plotësimit të formularëve të ndryshëm, jepni vetëm informatat e kërkuara që janë të shënuara me shenjën e yllit (*);
- Vërtetoni se një faqe interneti është e sigurt duke kërkuar shenjat identifikuese.



Lojërat Online

Të luani lojëra në kompjuterin tuaj është shumë e këndshme dhe argëtuese, mirëpo lojërat kanë edhe rreziqe. Ju mund të luani me kompjuter, telefona mobil, në rrjete sociale (psh. Facebook) apo me pajisje të vogla elektronike siç janë PlayStation dhe Nintendo. Ju gjithashtu mund të luani vetëm, me fëmijë të tjerë në dhomë, apo luani online me

njerëz të tjerë nga e gjithë bota, si janë shoqëria juaj apo edhe persona që nuk i njihni. Mirëpo, nëse luani lojëra në internet, duhet ta keni parasysh se jeni të ekspozuar ndaj disa rreziqeve në vijim:

- Ju mund të shkarkoni (download) gjëra të këqija së bashku me instalimin e lojërave.

Është dukuri e shpeshtë që kur ofrohen lojëra për tu instaluar gjatë bisedave chat me shokët e juaj, apo gjatë shkëmbimit të e-mailave, ato ofrohen edhe me ndonjë virus i cili mund të ketë spam, apo malicious software. Nganjëherë lojërat që janë falas (free) mund të pyesin për informata shitesë përveç atyre që i keni në profilin tuaj dhe ata që lansojnë virusin mund të keqpërdorin të dhënat tua personale.

- Kur luani me lojëra online, shpeshherë paraqiten pup-ups (faqe interneti të cilat hapen vetë pa i thirre ju paraprakisht) në ekranin tuaj, si psh. fotografi të vajzave të zhveshura, ose reklama të ndryshme, dhe hapja e tyre gjithashtu mund të jetë me viruse që ju nuk i vëreni dhe ato instalohen në kompjuterin tuaj.
- Një dukuri tjetër e rrezikshme është takimi me njerëz të këqij. Ka persona të këqij, që shpesh janë të rritur, që dëshirojnë për tu shoqëruar me fëmijë. Me qëllim që tu bëjnë keq më vonë, ata në fillim përpiqen të fitojnë besimin e lojtarëve duke pretenduar se janë fëmijë dhe duke ju ofruar 'trika' të ndryshëm se si të fitohet loja apo duke ju falur pikë (ponits). Takimi me këta njerëz që mund t'i njihni vetëm përmes internetit është me rrezik.

- Ajo çfarë ju duhet të bëni është që të mos mbani sekrete me prindërit tuaj për gjërat që ju dyshoni se ka diçka shqetësuese në to. Ju duhet të bisedoni shtruar me prindërit dhe ta rrisni komunikimin për gjithçka që ju bëni në internet.
- Nëse ndonjëri me të cilin jeni duke luajtur sillet keq me ju , ju bënë presion dhe kërkon informata personale apo ju dërgon materiale shqetësuese, atëherë ju duhet të kërkonit të ndërpresin këtë sjellje, ta injoroni apo t'ia bëni bllok. Gjithashtu kur jeni duke luajtur në internet duhet të keni kujdes që kur jeni fitues apo humbës të mos e bezdisni apo fyeni dikë në internet që luan bashkë me ju.
- Rekomandohet që fëmijët të luajnë me prindërit e tyre në mënyrë që edhe ata të vlerësojnë lojën që ju bëni dhe të vlerësojnë se kur kyçeni në loja online, ju luani të sigurt.
- Gjithashtu rekomandohet që fëmijët të luajnë lojëra që kanë reputacion (rating) të mirë, sepse këto lojëra janë më të sigurta, rreziku për viruse gjatë instalimit është më i vogël.
- Asnjëherë mos shpërndani informata tuaja personale ose informatat e anëtareve tjerë

të familjes (për shembull: emrat, adresën, e-mailin, moshën, fotografitë, e informata të ngjashme) me lojtarët e tjerë.

- Mbroni llogaritë tuaja kur i hapni me fjalëkalim të fortë. Fjalëkalimet (password) e fortë kanë së paku tetë karaktere dhe përfshijnë një kombinim të shkronjave të mëdha, numrave, shkronjave të vogla, dhe simboleve.
- Kur luani online, rekomandohet që të përdorni nofka në mënyrë që të mos zbulohet identiteti i juaj. Në asnjë mënyrë mos i ndani informatat tuaja personale me njerëz të panjohur për ju. Fëmijët e tjerë me të cilët luani lojëra online, nuk duhet të dinë emrin tuaj të vërtetë, adresën apo informata tjera tuaja personale.
- Gjithmonë pyetni prindërit apo kujdestarët tuaj para se të filloni të luani ndonjë lojë të

re në internet. Ata mund të ju ndihmojnë të zgjidhni lojërat më të mira dhe ju mund t'i mësoni prindërit se si të luajnë edhe ata këto lojëra bashkë me ju.

- Gjithashtu rekomandohet që të luani korrekt dhe ti trajtoni të tjerët ashtu siç dëshirojnë ata të trajtohen. Nuk rekomandohet të përdorni lojëra të kopjuara dhe të pa licencuara (lojëra pirate) sepse ato janë të paligjshme dhe shpeshherë përmbajnë viruse apo 'malware'.
- Pajisni kompjuterin tuaj me antivirus dhe asnjëherë mos e ndalni (fikni) "firewall"-in në kompjuterin tuaj.
- Ju nuk duhet të lejoni veten të bëheni të varur pas lojërave në internet, sepse kjo mund të ju kushtoj shumë në shëndet, mësim dhe financiarisht.



Rreziku ndaj ekspozimit të materialeve me përmbajtje të papërshtatshme

Me që në internet sot mund të kyçet gati gjithsecili dhe të ngarkoi çfarëdo materiale, atëherë edhe përmbajtja e materialeve që gjinden në internet është e shumëllojshme. Në përgjithësi ka dy lloje të përmbajtjeve: ato për të mësuar dhe të tjerat për tu argëtuar. Mirëpo, jo të gjitha përmbajtjet

që janë në internet janë të përshtatshme për të gjitha moshat. Disa përmbajtje nuk rekomandohet të shikohen nga fëmijët e moshave nën 18 vjeç. Kjo për faktin se fëmijët e kësaj moshe ende nuk janë të gatshëm për të parë këto informacione. Shikimi i tyre mund të ketë efekte negative psikologjike

dhe mund të ndikoi në zhvillim jo të shëndetshëm të fëmijëve.

Në Kosovë, fatkeqësisht, gati të gjitha përmbajtjet materialeve të papërshtatshme janë lehtë të arritshme dhe gjithsecili është i ekspozuar ndaj tyre. Në vendet e zhvilluara, videot e dhunshme, si psh. ato nga luftëra të ndryshme apo video e faqe interneti me përmbajtje erotike që nuk preferohet të shikohen nga fëmijë, nuk mund të shikohen nga fëmijët. Këto çështje në vendet e zhvilluara të Evropës perëndimore janë të rregulluara si nga ana ligjore po ashtu edhe për nga ana teknike.

Në Kosovë, bazuar në një hulumtim që ka bërë FIT në vitin 2012 dhe 2014 me fëmijët e shtatë shkollave në shtatë qytetet kryesore të Republikës së Kosovës ka dalë që fëmijët kosovarë janë mjaft të ekspozuar ndaj shikimit të materialeve me përmbajtje që nuk është e papërshtatshme për moshat e tyre. Materiale me përmbajtje të papërshtatshme mund të jenë fotografi erotike, video pornografike, video ku shfaqet dhunë, etj.

Teknologjia është duke u zhvilluar me një ritëm të shpejtë dhe mundësitë janë të mëdha. Shfletimi i faqeve në Kosovë në përgjithësi është i pakufizuar. Fëmijët inkurajohen që të kyçen sa më të sigurt në internet në mënyrë që të menaxhojnë rrezikun kur janë online. Kyçja në faqe jo të sigurta dhe shkarkimi (download) i materialeve jo të

përshtatshme për moshat e reja mund të rezultoi edhe me viruse të ndryshme. Rreziqet nga kyçja jo e sigurt janë të shumta. Prandaj fëmijët duhet të njihen me rreziqet potenciale që mund të paraqiten nga shikimi i pamjeve apo përmbajtjeve të dëmshme, shqetësuese dhe ilegale. Fëmijët, por edhe të rriturit, ekspozohen për shkak të të ashtuquajturve sulme 'spam' apo virusë të ndryshëm. Prandaj fëmijët duhet të pajisen me njohuri të nevojshme për tu mbrojtur dhe për të shfletuar të sigurt në internet.

Pasojat nga shikimi i pamjeve të papërshtatshme për fëmijë janë të shumta, por më të rëndësishmet ndikojnë në:

- shëndetin emocional dhe mendor të fëmijëve;
- promovojnë "mungesë të edukimit" seksual;
- është një falsifikues për dashuri erotike dhe intimitet;
- mëson se "argëtimi i të rriturve" është normal dhe i dëshirueshëm;
- bën të pandjeshëm shikuesit dhe rrit një oreks për llojet më të devijuara, të çuditshme, ose të dhunshme të pornografisë;

- ruan imazhet që nuk mund të fshihen asnjëherë;
 - ndihmon agresionin seksual;
 - mund të çojë në mishërim (adhurim obsesiv ndaj pjesëve të trupit dhe vlerësimit të femrave nga madhësia dhe forma e këtyre pjesëve);
 - mund të çojë në rritjen e egërsisë seksuale ndaj femrave; dhe
- mund të shkaktojë ose nxisë përdhunimin, i cili si është një vepër penale

Fëmijët duhet të kuptojnë që materialet që nuk janë të dedikuara për ata nuk duhet të shikohen nga moshat e tyre. Ata kanë të drejtë të mësojnë më shumë për tema të ndryshme dhe të rrisin vetëdijesimin edhe për temat siç është seksualiteti i shëndoshë, respektin për veten e tyre dhe seksin e kundërt;





Varësia nga interneti dhe kompjuteri

Edhe pse koha e kaluar në internet shpesh mund të jetë jashtëzakonisht produktive, përdorimi i pakontrolluar i internetit mund të ndikoi negativisht në jetën e përditshme, në punë, dhe aspekte të tjera të jetës shoqërore. Dëshira e tepërt apo pasioni në rritje i fëmijëve për të qëndruar pranë kompjuterit apo telefonit mobil, shumë shpejt mund të kthehet në një varësi të përdorimit të

internetit. Varësia nga interneti është një term që përdoret për të shpjeguar përdorimin e tepruar të internetit nga përdoruesit e tij. Mund të thuhet se fëmijët janë të varur nga përdorimi i internetit dhe kompjuterit nëse: (1) ata ndihen më të rehatshëm me shokët e tyre në internet se sa me shokët e tyre të vërtetë, ose (2) ata nuk mund të ndalojnë veten nga lojërat në kompjuter, telefon të mençur,

iPad, ose pajisje të tjera të ngjashme edhe kur janë të vetëdijshëm se vazhdimi i lojës ka konsekuenca negative në jetën e tyre. Këta persona e kanë fiksuar përdorimin e internetit, dhe nuk mund të funksionojnë natyrshëm pa u kyçur në të.

Varësia nga interneti, që ndryshe njihet edhe me emrin varësia nga kompjuteri apo varësia online, përfshinë një mori të problemeve siç janë:


- Varësia nga kompjuteri – personat që janë të fiksuar (të dhenë) pas lojërave të instaluara në kompjuter apo telefona të mençur;
- Ai ose ajo ka nevojë për të shpenzuar periudhë të gjata kohore në internet në mënyrë që të ndjehet i kënaqur, nuk ndihet rehat pa u kyçur në internet dhe nuk e kontrollon dot kohën;
- Shikimi i pamjeve të papërshtatshme për fëmijët – shikimi tej mase i materialeve të papërshtatshme, përdorimi i forumeve për të rritur, anoreksia dhe problemet me gjumin;
- Varësia nga rrjetet sociale - fëmijës nuk i mbetet kohë e mjaftueshme as për të bërë detyrat e shtëpisë;
- Lojërat online – dhënia tej mase mbas lojërave online, duke luajtur koha ka ikur dhe janë vonuar për shkollë, telashe në kompletimin e detyrave të shtëpisë dhe mësimëve, performancë e dobët në mësim, etj;
- Probleme familjare - Prishja e raporteve me prindërit dhe familjarët; prishje e raporteve me të afërmit e tjerë. Injorimi ose izolimi nga familja dhe shoqëria;
- Probleme në shkollë - Më shumë kohë shpenzohet duke kërkuar se sa duke kryer detyrën; detyra të pa kryera ose të pakompletuara; paaftësi për tu përballur me jetën reale; humbje e orëve të mësimit duke qëndruar në chat;
- Probleme me shëndetin dhe efektet tjera fizike –Pagjumësidhe shqetësim në të fjetur. Terje dhe lodhje e syve. Dhimbje të shpinës, qafës dhe kokës. Ushqyeshmëri jo e rregullt. Anoreksi. Shtim i theksuar në peshë ose humbje peshe;
- Pamundësi për të stopuar aktivitetin; Ndjenjë e vetmisë, depresionit, dhe iritimit kur nuk janë tek kompjuteri;

- Ndjehen mirë ose euforik kur gjenden para kompjuterit.

Është me rëndësi të theksohet se personat që kanë disa nga këto shenja janë në rrezik prej varësisë nga interneti dhe kompjuteri, dhe duhet që të ndërmarrin masa për të dalë nga kjo situatë. Ne rekomandojmë t'i ndiqni udhëzimet për të parandaluar varësinë e mëtutjeshme nga interneti, por nëse keni shumicën nga to, lexoni patjetër deri në fund këtë udhëzues. Si punë e

parë për ta luftuar këtë fenomen është të kërkonit ndihmë nga prindërit apo nga mbikëqyrësit tuaj. Ata do të ushtrojnë kujdes më të veçantë ndaj jush, do të shpenzojnë më shumë kohë me ju duke ju ndihmuar rreth mësimave apo thjeshtë duke u argëtuar me ju. Ata gjithsesi do t'ju ndihmojnë ta limitoni kohën e shpenzuar në internet, qoftë edhe duke kërkuar këshilla nga psikologu apo ndonjë ekspert me përvojë nga kjo lëmi.





Rreziqet tjera në internet për fëmijët

TAKIMI ME NJERËZ TË PANJOHUR

Gjatë përdorimit të rrjeteve sociale që mundësojnë chat-e, biseda online, ju njiheni ndonjëherë me miq të rinj virtual. Por ndonjëherë mund të takoni edhe njerëz të tillë që nuk kanë kurrfarë qëllimi të mire, e që fshihen prapa profileve dhe identiteteve të rrejshme me qëllim të takohen me ju dhe t'ju

shqetësojnë apo abuzojnë me ju në forma të ndryshme. Prandaj duhet të jeni të vetëdijshëm që nëse ndonjë shok-shoqe e juaja që e keni njohur vetëm përmes internetit, kërkon të takohet me ju, apo ju dëshironi ta njihni edhe në botën reale, patjetër duhet të diskutoni më parë me prindin tuaj

apo një të rritur të besueshëm. Të rriturit e kuptojnë më mirë nëse keni të bëni me persona keqbërës apo me persona të mirë. Këtyre personave pavarësisht që mund të duken të mirë asnjëherë mos u jepni detaje të sakta të vendndodhjes tuaj, adresës apo shkollës që vijoni, para se të diskutoni me dikë të rritur pranë jush. Nëse prindërit tuaj, pasi të kenë kontrolluar bisedën tuaj dhe profilin e personit tjetër, ju lejojnë të takoheni me dikë që

keni njohur vetëm online, ju mund të takoni atë vetëm në ndonjë vend publik, gjatë ditës dhe duhet që patjetër të jeni të shoqëruar nga prindërit apo ndonjë i rritur i besueshëm. Meqë kurrë nuk i dihet, gjithmonë është rreziku që ju të bëheni viktimë e dikujt që dëshiron të ju lëndojë ju, shoqërinë apo familjen tuaj.

TRAFIKIMI I FËMIJËVE

Si në gjithë botën, trafikimi i fëmijëve si dukuri ekziston edhe në vendin tonë i cili kryhet nga persona të panjohur dhe të cilët e bëjnë këtë gjë për përfitime personale. Pjesë e kësaj dukurie në shumicën e rasteve janë fëmijët dhe adoleshentët e të dy gjinive.

Çka është trafikimi i fëmijëve dhe cilat janë këshillat që do të ju ndihmojnë të rriini gjithmonë larg këtij fenomeni?

Trafikimi i qenies njerëzore është rrëmbimi apo lëvizja e një fëmije apo adoleshenti me qëllim të shfrytëzimit për përfitime personale. Trafikimi i qenieve njerëzore kryhet kryesisht nga rrjete kriminale të cilat kanë qëllim të vetëm përfitimin material. Këto rrjete kriminale targetojnë kryesisht fëmijët si pjesë e pambrojtur e shoqërisë, të cilët

pa vullnetin e tyre detyrohen të kryejnë punë të pandershme; blihen dhe shiten për qëllime të ndryshme dhe detyrohen të ofrojnë kënaqësi seksuale personave të ndryshëm. Trafikimi i qenieve njerëzore mund të ndodhë brenda vendit, por shpesh edhe në vende tjera jashtë shtetit. Këto ngacmime mund të ndodhin në jetën reale por edhe në internet nëpërmjet kanaleve të komunikimit si: rrjetet sociale, mesazhe përmes email-ave, sms dhe chat-it. Andaj, gjithmonë duhet të keni kujdes me kë bisedoni në internet.

ABUZIMI SEKSUAL NDAJ FËMIJËVE

Abuzimi seksual ndaj fëmijëve është formë e detyrimit për marrëdhënie seksuale ndaj një fëmije nga një person i rritur. Abuzimi seksual mund t'ju ndodh meshkujve dhe femrave që mund të kryhet edhe përmes internetit dhe në realitet. Kjo dukuri në të gjitha mënyrat konsiderohet krim.

Askush nuk ka të drejtë të abuzojë dikë me motive seksuale. Andaj, nëse ballafaqoheni me këtë dukuri patjetër duhet të komunikoni me prindërit, të cilët do të ju ndihmojnë që ta ndalin personin

SHKARKIMI, SHKËMBIMI DHE POSTIMI

Shkëmbimi i skedarëve (fajllave) është ndarja e informacioneve dixhitale siç janë programet kompjuterike, fajllat muzikor, videot, filmat, fotografitë, apo dokumentet dhe librat elektronik me personat e tjerë nëpërmjet internetit. Shkëmbimi i këtyre materialeve është një dukuri shumë e zakonshme nga të rinjtë në Kosovë dhe ky aktivitet është një pjesë argëtuese që ofron interneti dhe aplikacionet tjera të lidhura me internetin. Të rinjtë mund të hasin në rreziqe kur shkarkojnë muzikë, filma, fotografi etj., pasi që ato mund të përmbajnë viruse apo imazhe të këqija.

që ju detyron të bëni gjëra të tilla. Një dukuri e tillë gjithmonë duhet të tregohet dhe të parandalohet menjëherë. Gjithashtu mund të lajmëroni policinë e Kosovës duke thirrur në numrat: 192 nga telefoni celular (vala/ipko) dhe në numrin 92 nga telefoni fiks, si dhe mund t'i shkruani mesazh elektronik në adresën info@kosovopolic.com.

Qendra FIT sipas hulumtimit që ka bërë me fëmijët Kosovarë ka evidentuar që fajllat më të shpeshtë që fëmijët ndanë janë fotografitë, muzika pirateske, filmat dhe programet kompjuterike. Nëse dëshironi të shkarkoni ndonjë nga fajllat e përmendur, rekomandohet që kjo të bëhet nga faqet e njohura, të cilat në të shumtën e rasteve kërkohet të paguani, mirëpo këto faqe interneti janë më të sigurta. Në të kundërtën, shkarkimi nga interneti falas mund të ju fus në telashe sepse shumica e këtyre faqeve që ofrojnë këto gjëra falas ose janë jolegale (shkelet e drejta

KENI KUJDES...

Nëse keni ndonjë informatë lidhur me trafikim të fëmijëve, menjëherë duhet t'i njoftoni prindërit tuaj apo familjarët tjerë që të ju dalin në ndihmë dhe ta parandalojnë këtë gjë që mund të ju vë në rrezik eventual. Gjithashtu mund të lajmëroni policinë e Kosovës në numrat e telefonit 192 nga telefoni celular (vala/ipko); në numrin fiks 92 nga telefoni fiks, si dhe mund t'i shkruani e-mail në adresën info@kosovopolic.com.

e autorit) ose e bëjnë me qëllim që të shpërndajnë viruse apo reklama të ndryshme.

Nëse ju shkarkoni muzikë, filma, programe apo lojëra nga faqet e panjohura, ekziston mundësia që të futni shumë virus në kompjuterin tuaj. Në raste të tilla, shpesh mund të ndodh të instaloni pa dashje programe që shfaqin reklama kur ju hapni programet e caktuara (pop-up) ose viruset paraqesin fotografi të papërshtatshme për moshën tuaj. Gjëja më e mirë që duhet bërë është të kërkoni nga një i rritur në familjen tuaj për të shkarkuar diçka që ju dëshironi, kështu që ju nuk futeni në telashe.

Nëse ju postoni fotografi tuajat, është mirë të bënë caktimin e të drejtës së autorit për fotot tuaja, sepse është e mundur që njerëzit të përdorin fotot tuaja për reklama ose për qëllime të tjera.

Gjithashtu është me rëndësi që përdoruesit të përcaktojnëse kush mund të ketë qasje në fotot e tyre të ngarkuar në internet. Fotot mund të ngarkohen dhe të shikohen nga të gjithë apo të caktohet një listë e personave që mund ti shohin ato. Rekomandohet që fotografitë personale private të ndahen vetëm me miqtë e ngushtë dhe familjen.

VIRUSET, SIGURIA KIBERNETIKE, ETJ.

Gjatë përdorimit të internetit në pajisjen tuaj ju mund të jeni viktimë e viruseve apo sulmeve kompjuterike. Viruset janë programe të vogla softuerike që sulmojnë sistemin operativ (të funksionimit) të kompjuterit. Një virus kompjuterik mund të korruptojë-shkatërrojë të dhënat në pajisjen tuaj, mund t'i fshijë ato, apo të vjedhë informatat tuaja që ruani në të. Virusi është bërë për t'u shpërndarë nga njëri kompjuter- në tjetrin. Ata shpesh shpërndahen si fajlla të bashkangjitur përmes e-mailit, si vegëza në bisedat e chatit, apo gjatë shkarkimit apo instalimit të ndonjë programi kompjuterik online.

Zakonisht për t'u mbrojtur nga këto sulme kompjuterike duhet të bëni përditësimet-updates më të fundit në kompjuterin tuaj dhe të përdorni antivirus. Më poshtë gjeni edhe disa këshilla që ju mësojnë si të njihni disa nga masat parandaluese për të mos u bërë viktime e sulmeve nga viruset.

Nuk është mirë të hapni mesazhet nga persona të panjohur, aq më pak të shkarkoni përmbajtje apo të klikoni mbi vegëzat e bashkangjitura edhe kur ato duket që mund të përmbajnë fotografi qesharake, apo kartolina për urim të festave. Meqë shpesh viruset janë të maskuar si të tilla. Me hapjen e

këtyre mesazheve lehtë mund të shpërndani pavetëdije këto viruse tek të gjithë miqtë tuaj në internet. Po ashtu para se të shkarkoni ndonjë muzikë, apo të instaloni ndonjë lojë të re online, është mirë të kërkonti ndihmë nga prindërit tuaj, apo ndonjë i rritur i besueshëm, meqë shumë shpesh, viruset fshihen në këto uebfaqe ilegale.



TELEFONI CELULAR

Ju mund të përdorni telefonin mobil për të biseduar me njerëz dhe të dërgoni mesazhe me tekst. Telefonat celular tanimë mundësojnë të dërgoni fotografi dhe video të ndryshme. Shumica e telefonave që njerëzit përdorin në ditët e sotme kanë edhe një aparat fotografik të integruar në telefon. Andaj, ju mund të bëni fotografi në çdo kohë që ju doni dhe t'ua dërgoni atë miqve tuaj.

Rekomandohet që numrin tuaj të telefonit celular ta kenë vetëm njerëzit që ju i njihni, në mënyrë që të mos merrni telefonata apo mesazhe nga njerëz të panjohur të cilët mund të ju shqetësojnë për gjëra të ndryshme.

KENI KUJDES...

- Sigurohuni që ju të keni antivirusin të efektshëm dhe të përditësuar/ anti-spyware software dhe firewall përpara se të filloni shkarkimin.
- Mos shkarkoni dhe postoni pa lejen e prindërve.
- Shkarkimi pa pagesë i muzikës dhe filmave është jo ligjor.
- Shkarko muzikë vetëm nga faqet e paguar të tilla si iTunes, ose faqet e internetit nga shitësit e besuar.
- Shkarko softuere vetëm nga uebfaqet e prodhuesve ose shitësve të autorizuar.
- Mos postoni përmbajtje të cilat nuk doni të shihen nga prindërit, mësuesit ose miqtë e juaj.
- Mos shpërndani materiale që është nën të drejtën e autorit (copyright).

CHAT

Përdorimi i aplikacioneve të ndryshme për komunikim në internet është një mënyrë e mirë për të biseduar me miqtë dhe familjen. Gjithmonë përdorni një shkurtësë të emrit tuaj apo ndonjë nofkë tjetër që mos të identifikoheni saktësisht se kush jeni. Miqve apo njerëzve që ju i njihni, mund t'ua tregoni shkurtësën e emrit tuaj që ata të ju identifikojnë juve, por këtë informatë mos e bëni publike. Mbrojtja e informatave personale është gjithë shumë e rëndësishme që ju të mos ballafaqoheni me ndonjë dukuri negative gjatë komunikimit në internet,

që mund të ju vijë nga njerëz të panjohur. Nëse merrni mesazhe nga persona të panjohur, asnjëherë mos ju përgjigjuni dhe mos hyni në bisedë me ta. Gjithmonë në këso lloj situatash është mirë t'i informoni prindërit.

Shumica e aplikacioneve për komunikim në internet ofrojnë mundësinë e përdorimit të kamerave që të shiheni me miqtë tuaj direkt gjatë bisedës në internet.

E-MAIL



Përdorimi i adresës elektronike (e-mail) është një mënyrë shumë e mirë për të shkëmbyer email-a të ndryshme me miqtë dhe familjarët tuaj. Në moshën tuaj, ju mund ta përdorni adresën tuaj elektronike për të komunikuar me shokët dhe familjarët tuaj që jetojnë në vende të ndryshme të botës. Ju mund të shkruani email shumë shpejtë dhe të shkëmbeni fotografi me shokët dhe familjen tuaj.

KENI KUJDES...

Mos e postoni numrin tuaj mobil në profile. Tregoni numrin e telefonit tuaj vetëm atyre që i njihni dhe ju besoni.

Mos lejoni të panjohurit të përdorin telefonin tuaj mobil.

Asnjëherë mos iu përgjigj ngacmuesve. Mos i lexoni mesazhet e tyre, bllokoni ata persona dhe mos komunikoni me ta.

Nëse dikush ju ngacmon apo shqetëson përmes mesazheve, ruani dëshmitë dhe mundohuni ta identifikoni personin i cili ju ngacmon!

Është shumë me rëndësi që email-a të dërgoni vetëm te personat që ju i njihni. Gjithashtu kur merrni mesazhe nga personat që ju nuk i njihni, atëherë rekomandohet që atë email ta fshini menjëherë pa e hapur, duke parandaluar ndonjë pamje jo të përshtatshme për

moshën tuaj apo infektim të kompjuterit tuaj.

Shumica e aplikacioneve për komunikim në internet ofrojnë mundësinë e përdorimit të kamerave që të shiheni me miqtë tuaj direkt gjatë bisedës në internet.

FORUMET

Forumet e diskutimit në internet janë një vend për të takuar njerëz me të cilët ju mund të flisni për të gjitha gjërat. Në internet mund të gjeni forume të ndryshme që ju japin mundësi të flisni për të gjitha gjërat dhe madje të takoheni online me njerëz që

duan të njëjtat gjëra si ju. Ju mund të lexoni mesazhet që janë shkruar nga njerëzit e tjerë dhe mund t'u përgjigjeni mesazheve duke shtuar përgjigjet apo idetë tuaja.

TË DREJTAT E FËMIJËVE NË INTERNET

- Keni të drejtë të ndjeheni i sigurt dhe të jeni i sigurt në Internet.
- Keni të drejtë të hulumtoni, mësoni dhe kënaqeni në internet.
- Keni të drejtë të mbani të fshehta informatat e juaja personale.
- Keni të drejtë që të tjerët të mos ju shqetësojnë ose ngacmojnë.
- Keni të drejtë t'i injoroni e-mailat dhe mesazhet nga njerëzit të cilët nuk i njihni ose nuk ju besoni.
- Keni të drejtë që të mos plotësoni formularët ose të mos përgjigjeni në pyetjet e parashtruara në internet.
- Keni gjithmonë të drejtë të kërkonti ndihmë nga prindi ose një i rritur.

KENI KUJDES...

Mbani në mend: natyra e internetit është e tillë që për shumë njerëz është e lehtë të pretendojnë që janë dikush tjetër nga ajo që në të vërtetë janë.

GJITHMONË duhet të keni kujdes se çfarë informatash jepni gjatë bisedave në chat. Kontakti me njerëz të panjohur mund të jetë i rrezikshëm.

ASNJËHERË nuk duhet të takoheni me personat që i njihni vetëm online. Ju nuk e dini se kush janë ata në të vërtetë. Mos përdorni kamera në internet me persona të panjohur.

- Keni të drejtë ta raportoni çdonjërin që mendoni se është duke u sjellë çuditshëm ose bën pyetje të çuditshme.
- Keni të drejtë që të mos ndiheni fajtor nëse papritmas

paraqiten në ekranin tuaj pamje të neveritshme dhe përmbajtje ofenduese.

- Keni të drejtë që të tjerët në internet të ju respektojnë.

PËRGJEGJËSITË E FËMIJËVE NË INTERNET

- Duhet të siguroheni që të dhënat e juaja personale të jenë të private dhe të mos mund të shihen nga të panjohurit.
- Duhet të siguroheni që të mos postoni fotografi apo video të të tjerëve pa lejen e tyre.
- Duhet të siguroheni që të mos hapni asnjë e-mail, uebfaqe apo mesazh të panjohur.
- Duhet të siguroheni që të mos fyeni, ngacmoni apo mashtroni dikë përmes internetit.
- Duhet të siguroheni që të mos flisni gjëra shumë të rëndësishme në internet me persona të ndryshëm.
- Duhet të siguroheni që të jeni tolerant ndaj personave të tjerë që përdorin internetin.
- Duhet të siguroheni që të respektoni të gjithë përdoruesit e internetit.

KENI KUJDES...

Mos i hapni e-mailat nga personat e panjohur. Shumica e viruseve barten përmes materialeve që dërgohen të bashkëngjitura me e-mail (attachments) nga ata persona. Asnjëherë mos i dërgoni fotografitë tuaja personale ndonjë të panjohuri. Nuk duhet hapur “fajllat” apo “vegzat” përveç nëse e dini sigurt se çfarë janë ato. Gjithmonë bisedoni me prindin tuaj para se të shkarkoni për të instaluar ndonjë software.

DISIPLINA DHE KUJDESI NË INTERNET

Është me rëndësi që ju të përdorni internetin për qëllime të mira duke mos ofenduar, fyer apo edhe keqpërdorur ndonjë person që ju nuk e njihni. Edhe pse ju nuk mund ta shihni personin tjetër gjatë komunikimit në bisedat në internet, gjuha që ju përdorni duhet të jetë

shumë e pastër. Ofendimet, fyerjet dhe sharjet mund të shkaktojnë ndonjë incident eventual apo ballafaqim me diçka të jashtëligjshme.

KËSHILLA SE SI TË MBROHENI NË INTERNET

- Konsultohuni me prindërit apo kujdestarët tuaj për përdorim të sigurt të internetit.
- Kur përdorni aplikacionet për komunikim në internet, gjithmonë përdorni një nofkë apo një shkurtesë të emrit tuaj në vend të emrit të vërtetë.
- Interneti është burim i informatave dhe një vend i mrekullueshëm për t'u lidhur me miqtë. Bëhuni të mençur dhe shfletoni të sigurt online.
- Gjithmonë pyetni një të rritur para se të filloni të përdorni internetin. Ata mund të ju ndihmojnë të gjeni gjëra shumë të mira që ju të argëtoheni gjatë përdorimit të internetit.
- Gjithmonë flisni me prindërit apo kujdestarët nëse keni dyshime për ndonjë person gjatë bisedës në internet. Tregoni prindërve apo kujdestarit tuaj në qoftë se ju ndiheni të frikësuar apo të pakënaqur për ndonjë gjë që ju ka ndodhur në internet.
- Nëse dikush ju dërgon ndonjë mesazh që ju bën të ndiheni të mërzhitur ose të shqetësuar, njofto menjëherë prindërit ose mësuesin.
- Mendo mirë para se të postosh diçka në internet, sepse fjalët e tua dhe fotografitë tuaja mund të ndikojnë në reputacionin tuaj dhe mund të dëmtojnë suksesin tuaj në të ardhmen.

KENI KUJDES...

Gjithmonë lexoni rregullat e përdorimit të forumit.

Bëhu i sjellshëm dhe respekto të tjerët.

Mos i gjyko të tjerët në forume lidhur me racën, fenë, gjininë dhe mos posto mesazhe me përmbajtje fyese. Mos përdorni emrin tuaj të vërtetë gjatë diskutimeve në forume. Përdorni pseudonime sepse në shumicën e forumeve ju nuk mund t'i fshini informatat tuaja personale.

- Nëse hasni në ndonjë mesazh ose fotografi me përmbajtje erotike ose të paligjshme njoftoni prindërit ose kujdestarin tuaj. Mendoni dy herë para se të publikoni apo shpërndani diçka në internet.
- A dëshironi vërtetë që informacionet që postoni të jenë publike? Atë që ju e publikoni njëherë, mbetet aty dhe mund ta shohë apo keqpërdorë kushdo.
- Mendoni mirë para se të vendosni të takoni një mik që e ke njohur vetëm përmes internetit. Asnjëherë mos i dërgoni fotografitë tuaja personale ndonjë të panjohuri.
- Mos i ndani detajet e jetës tuaj me të panjohurit online. Kontrolloni masat e privatësisë. Nëse ke ndonjë problem apo shqetësim, bisedo me një të rritur që të mund të ndihmojë.
- Jini përgjegjës për veprimet e tuaja online ashtu sikur në jetën e përditshme.
- Nëse kërkonte ndonjë informacion në internet, verifikojeni në së paku dy uebfaqe të ndryshme ose në libra sepse jo gjithçka që shihni në internet është e vërtetë.
- Mbani fjalëkalimet tuaja sekret. Për të bërë fjalëkalimin tuaj më të sigurt përfshini numra dhe simbole, dhe ndryshoni atë shpesh.
- Shmangni kontaktet me të panjohurit. Dikë që keni njohur vetëm përmes internetit asnjëherë mos e takoni pa lejen dhe prezencën e prindit.
- Asnjëherë mos i tregoni personave të panjohur se ku jetoni, mos i tregoni numrin tuaj të telefonit, adresën elektronike, apo ku shkoni në shkollë. Vetëm miqtë tuaj dhe familjarët tuaj duhet të dinë këto informata personale.
- Mos i hapni fajllat e bashkëngjitur në e-maila nëse ata vijnë nga adresa të panjohura për ju, sepse mund të përmbajnë viruse ose mesazhe me përmbajtje të pakëndshme.
- Mos dërgoni fotografitë tuaja te njerëzit që ju nuk i njihni. Ju sigurisht nuk do të dëshironit që një i huaj të mbajë fotografitë tuaja apo familjes tuaj që mund të keqpërdoren.
- Respektoni të tjerët edhe në internet.

FJALORI TERMEVE TË INFORMATIKËS

Badware – Softuer (program) i keq që përmban viruse dhe spyware që vjedhin të dhënat tuaja personale, bëjnë mashtrime dhe dërgojnë spame. (Shih Malware.)

Backup – Marrja e kopjeve të të dhënave nga kompjuteri për shkaqe sigurie, që informacioni mos të humbet në rast se ndodh ndonjë prishje në kompjuterin tuaj.

Blockingsoftware (Program bllokimi) – Një program i cili filtron përmbajtje nga interneti dhe kufizon qasjen në sajtet ose përmbajtjen në bazë të kriterëve të veçanta.

Blog – shkurtësë e “web log,” një web faqe ku ju rregullisht mund të postoni informacionet, fotot, etj.

Browser (shfletues) – Program softuerik i përdorur për të gjetur dhe afishuar faqet e uebit. Disa shfletues lejojnë gjithashtu që përdoruesit të dërgojnë dhe të marrin e-postë, të lexojnë grupet e lajmeve dhe të lexojnë skedarët me video ose zë. Disa nga shfletuesit më të njohur janë: Internet Explorer, MozillaFirefox, Opera, GoogleChrome, etj.

Buddylist – Lista e njerëzve me të cilët ju mund të bisedoni me anë të një programi IM (mesengjeri).

Chat room (dhomë bisede) – Një hapësirë në internet ku ju mund të takohen dhe të shkëmbeni informacion nëpërmjet mesazheve të shfaqur në ekranet e të tjerëve që janë në “dhomë.”

Cyberbullying (sajber dhuna) – Dhunë ose ngacmim online; përfshin postime të turpshme, foto ose komente të pakëndshme në profilin e një personi ose dërgimin e tyre nëpërmjet mesazhëve ose me email.

Firewall – Harduerë ose softuerë që bllokun komunikimit të paautorizuar në ose nga kompjuteri juaj; ndihmon të mbrojt nga hakerat nga përdorimi i kompjuterit tuaj të dërgojë të dhënat tuaja personale pa lejen tuaj.

Flashdrive (disk i shpejtë) – Pajisje e vogël që përdoret për të ruajtur informacion. Disqet e shpejta me USB vendosen në portat e USB-së në kompjuter, në mënyrë që të kopjohet informacion në to ose prej tyre, duke lehtësuar përbashkimin dhe transportimin e informacionit.

Forum – faqe internet ku ju mund të shkëmbeni informata të ndryshme, për tema të ndryshme.

GPS – “Global Positioning System,” (Sistem i pozicionimit global) - një sistem satelitor global i navigacionit përdoret në makina apo telefona për të përcaktuar drejtimin dhe vendndodhjen.

Hacking –Thyerja në një kompjuter ose rrjet duke shmangur ose paaftësuar masat e sigurisë.

Hard disk (Disk i ngurtë) – Mjet i ruajtjes së të dhënave që përdor disqe të ngurta prej alumini të veshura me oksid hekuri. Koka për lexim-shkrim lëviz nëpër disk në një amortizues të hollë ajri pa e prekur asnjëherë diskun.

Disqet e ngurta kanë më shumë kapacitet ruajtjeje se disketat. Në fillimet e 1980, madhësia e zakonshme e disqeve të ngurta ishte 10 megabajt. Sot disqet maten me qindra gigabajt.

Instant messaging (IM) – Shërbim për mesazhe instant (masengjeri) – mundëson dy ose më shumë njerëzit për të biseduar në kohë reale, dhe ju njofton kur dikush është online në listën e miqëve.

Intellectual property (IP) – Pronësia intelektuale – Produktet Creative që kanë vlerë komerciale, duke përfshirë pronën copyright si libra, fotografi dhe këngë.

Java Script – Gjuhë e skriptuar që përdoret për të krijuar përmbajtje ndërvepruese ose të animuar për internet, si lojërat ose aplikacionet e përparuara financiare.

Limited user account – (Përdorues me llogari të kufizuar) – kur dikujt i lejohej qasje në disa funksione dhe programe të kompjuterit, por lejoi vetëm një administrator për të bërë ndryshime që ndikojnë në kompjuter.

Malware – “malicious software”;përfshin viruse dhe spyware që vjedhin informacionet personale, dërgojnë spam, dhe kryejnë mashtrim.

Malicious software (Softuer keqdashës) – Softuer që përmbush qëllimin e një sulmuesi për dëmtim të paramenduar gjatë ekzekutimit. Për shembull, viruset, karremat dhe trojanët janë kode keqdashëse.

Password (fjalëkalim) – Një fjalë sekrete apo fraza që e përdor një përdorues (username) për qasje në kompjuter ose mbrojtje informacioneve të ndjeshme në internet.

Patch – program i shkarkuar për të rregulluar apo freskuar një program kompjuterik

Personal information (të dhënat personale) – të dhënave që mund të përdoren për tju identifikuar ju, si emrin tuaj, adresën, ditëlindjen, etj.

Pop-up – Një dritare kërcyese që shfaqet në krye të (mbi) të dritares së shfletuesit të një uebfaqeje që ka vizituar një përdorues. Një dritare kërcyese është imponuese, pasi ajo mbulon dritaret e tjera, veçanërisht dritaren që përdoruesi po përpiqet të lexojë. Reklammat kërcyese përdoren gjerësisht në reklammat në ueb, megjithëse reklamimi nuk është i vetmi aplikacion për dritaret kërcyese.

Privacy settings (kontrolli i privatësisë) – menagjimi i privatësisë në rrjetet sociale dhe ëbsitet tjera ku ju mund të vendosni kufizime se kush mund të ket qasje dhe çfarë informata mund të shohin vizitorët në profilin tuaj.

Profile (profili) – një faqe personale që mund ta krijoni në një rrjet social apo faqe tjera të internetit për të shkëmbyer informacion rreth vetes dhe të komunikoni me të tjerët.

Securitysoftware (program i sigurtë) – Identifikon dhe mbron kundër kërcënimeve që mund të rrezikojnë kompjuterin tuaj ose informatat tuaja personale; përfshin anti-virus dhe anti-spyëare programe dhe fireëalls.

Sexting – dërgimi apo percjellja e fotove dhe mesazheve seksuale nga një telefon celular.

Smartphone (telefon i menqur) – telefon mobil që ofron veçori të avancuara si lidhje internet dhe media plejer portative.

SMS – Short MessagingService – teknologji që lejon mesazhet tekstuale të dërgohen nga një telefon mobil në një tjetër.

Social networking site (faqe e rrjetit social) – Një faqe interneti që ju lejon për të krijuar një profil dhe të lidheni me të tjerët.

SPAM – e-mail i padëshiruar apo e-mail i pranuar pa kërkesë të specifikuar nga pranuesi.

Spyware (Softuer spiun) – program i instaluar në kompjuterin tuaj pa lejen tuaj për të monitoruar dhe kontrolluar përdorimin e tij.

SSID-Service set identifier (Identifikuesi i bashkësisë së shërbimit) – Bashkësia unike e shkronjave ose e numrave që identifikon një rrjet pa tel. Një kompjuter ose pajisje që lidhet në një rrjet pa tel duhet të mbështesë atë SSID të rrjetit. Një SSID mund të jetë deri në 32 karaktere. SSID-të quhen ndonjëherë emrat e rrjetit. Gjithashtu si shkurtesë SSID.

Texting– dërgimi i mesazhit të shkurtër nga një telefon mobil në tjetrin.

Trojan horse (Kali Trojan) – Program i kompjuterit me funksion të fshehtë shkatërrues, si fshirja e disqeve në një datë të caktuar. Trojanët shpërndahen shpesh si versione “të reja” të falsifikuara të produkteve të softuerëve paralajmërues.

me tela. Këto rrjete janë duke u bërë gjithnjë e më popullore dhe të fuqishme, që lejojnë njerëzit të hyjnë në internet duke përdorur telefonat celularë dhe pajisje të tjera

User name (emri i përdoruesit) – një pseudonim që përdoret me fjalëkalim për të lejuar qasje në llogari dhe faqe të internetit.

Video calling (video thirrjet) – shërbime të internetit që u lejojnë përdoruesve të komunikojnë duke përdorur ëëbkamera.

Virus – Virus – Malware që që hyn tinëz në kompjuterin tuaj shpesh përmes një shtojce në e-mail pastaj bën kopje të vetë.

Webcam – Një video kamerë që mund të paraqës pamje drejtpërdrejtë në ëëbnëëëb, mund të jetë e integruar në kompjuter ose blihen veç e veç.

World Wide Web (WWW) – nuk është një sinonim për Internet. WorldWideWeb, ose thjesht “Web”, është një nëngrup i internetit. Web përbëhet nga faqet që mund të arrihen duke përdorur një shfletues web.

Wireless computers (Kompjuteri pa tela) – Rrjete që lejojnë qasjen në Internet pa u lidhur